



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/ Nr. 7643/2019
Data: 19.08.2019

PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverballi nga mbledhja e shtatë - VII- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 09.07.2019 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: Rufki Suma (Kryetar i Komunës), Nexhmedin Daci (Drejtore për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), Zaim Bela (Drejtore për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), Edon Curri (Drejtore për Administratë), Refet Kalisi (Drejtore për Shërbime Publike dhe Emërgjencë), Shabi Rexhallari (Drejtore për Buxhet dhe Financa), Bashkim Sopa (Zyrtar për Informim), Bajrush Laçi (Shef i Zyrës Ligjore), Përfaqësuesit e OSB-së. Kryesuesi i kuvendit pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të kuvendit, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i kuvendit të komunës.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Miratimi i grupit punues për hartimin e planit të punës së kuvendit të komunës për vitin 2020.
3. Informatë mbi raportin e auditorit të përgjithshëm për komunën për vitin 2018.
4. Plani i veprimit të Komunës së Hanit të Elezit për adresimin e rekomandimeve të raportit të auditimit 2018.
5. Miratimi i propozimit të planit të veprimit për transparencë 2019-2023.
6. Njoftim për aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për gjashtë mujorin e vitit 2019.
7. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- lidhur me rendin e punës hapi diskutimin.

Mefail Suma thekson:- duke marrë parasysh kushtet atmosferike që ka pak të reshura kam dëgjuar për fshatin Gorancë që janë në gjendje krize për ujë të pijes. Propozoj që të hyjë edhe një pikë e rendit të punës “ Miratimi i vendimit për ndarjen e ndihmës momentale për fshatin Gorancë ”. Mjetet financiare do të shërbejnë për kompensimin e shpenzimeve të krijuara për sigurimin e ujit të pijshëm, është fjala prej burimit që e përcjellin ujin deri te rezervari kryesor me pas rënie të lirë. Ndarja e mjeteve të bëhet nga të hyrat vetanake.

Mehmet Ballazhi thekson:- secili anëtarë ka të drejtë për pika të reja të rendit të ditës apo propozime, mirëpo jo që nuk është si propozim ndoshta i mirë por mua ma merr mendja duhet të formulohet pak më ndryshe përderisa është në këtë gjendje emergjente nëse thuhet kështu atëherë duhet të shpallet edhe si periudhë emergjente dhe një intervenim emergjent, e si pikë e rendit të ditës në debate nuk e di se çfarë duhet të diskutohet dhe çka duhet të merret ndonjë vendim ose ndonjë zgjidhje mobile përmes cisternave me ujë se përndryshe brenda një kohe shumë të shkurtër nuk mundemi t'i bëjmë zgjidhje cilit do fshat ose vendbanim. Jo rastësisht e kam përmendur edhe në KPF dhe seanca tjera se uji nuk është prioritet në asnjë plan të kryetarit as te buxheti nuk janë ndarë për ujërat me theks të veçantë jo veç në Han të Elezit por edhe në fshatrat përreth dhe vendbanime tjera hiq më larg se mbledhjen e fundit që përkon me kërkesën e z.Mefailit për një pikë te rendit të ditës pra duhet të diskutohet çështja për me i bë zgjidhje nëse është emergjente.

Kryesuesi thekson:- për pikën që kërkon ju e dini që për çështjen e ujit në krizë dhe gjendje emergjente është edhe Hani i Elezit dhe krejt trevat janë kështu që si pikë të rendit të ditës vetëm për Gorancën është diskriminim

se të njëjtin problem e kemi në krejt territorin e Hanit të Elezit, mirëpo i njëjti problem është edhe në krejt Kosovën por te të ndryshmet mundemi të diskutojmë nuk është problem.

Mefail Suma thekson:- na përsëriten gjërat prej vitit në vit unë e potencova këtë si ndarje e ndihmës momentale e jo të përhershme. Ato e kanë një burim të ujit diku poshtë fshatit për me të transferin apo bartjen e ujit për me dërguar në rezervar duhet të shpenzohet rrymë. Banorëve ju duhen 3000 € iu mjaftojnë se atje është burimi por vetëm nuk kanë mjetë për me të bartjen e ujit deri në rezervar. Unë kërkoj që propozimi të del në votim.

Kryesuesi thekson:- nuk po them që nuk ke të drejtë por është problemi se edhe arsyeshmërinë duhet ta kesh se pa një plan, pa një analizë çka për shembull vetëm ta miratojmë kështu që aty duhet të bëhet analizë nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, drejtoria përkatëse me të një analizë a ka nevojë apo nuk ka nevojë. Mundemi të të ndryshmet me biseduar e si pikë nëse nuk tërhiqesh e hedh në votim nuk është problem.

Akif Shkreta thekson:- është e vërtetë që çdo propozim i asamblistit që mendon se është e arsyeshme të diskutohet ndoshta edhe të nxjerr ndonjë vendim e në rastin në fjalë ne duhet të kemi dëshmi dhe argumente se a është gjendje me të vërtetë emergjente dhe nëse është emergjente duhet të formohet një komision emergjent kështu është rruga se ne nuk mundemi të ndajmë buxhet për shembull për diçka që nuk është koha për me ndarë buxhet kur e dimë si shkon ecuria e ndarjes së buxhetit. Mendimi im për këtë çështje është nëse duam ta bëjmë pikë si e bëjmë një pikë vetëm me diskutuar pa e pasur një raport. Ne duhet ta kemi një raport të “Bifurkacionit”, të Drejtorisë për Shërbime Publike dhe pastaj shkojmë te një pikë e diskutimit. Ku po bazohemi ne se nuk ka ujë në Gorancë, në çfarë dëshmi? Mos të bazohemi në individë. Cili institucion e ka thënë? Këshilli i Fshatit a ka parashtruar kërkesë dhënë më shkrim? Kështu shkon ecuria dhe pas diskutimit të një çështjeje të tillë kur marrim raportin e Bifurkacionit dhe të Drejtorisë së shërbimeve Publike e cila konstaton dhe identifikon problemet e ujit të pijes në Han të Elezit dhe kur të vjen koha e buxhetit mund ta ndajmë ose ta bëjmë prioritet ujin e pijes.

Mefail Suma thekson:- unë i kuptoj bashkëbiseduesit, nuk është hera e parë që e them e që jam asamblist. Prej pilot njësi komunale dhe më parë e di që Goranca e ka pasur një pompë që e përcjell ujin e shpenzimet prej korrikut e deri në shtator thonë fshatarët që janë deri në 3000 euro dhe ishin duke u munduar me mbledh mjete financiare prej atyre që janë në shtete të perëndimit sepse banorët nuk kanë mundësi.

Refet Kalisi thekson:- banorët e fshatit Gorancë kanë ujë por e kanë me reduktime dhe kemi pasur takim me drejtorin e kompanisë “Bifurkacioni” dhe me kryetarin e këshillit të fshatit Gorancë. Bifurkacioni ka dashur ta merr nën menaxhim edhe gypat me i funksionalizuar se ajo punë ishte kryer por ata nuk kanë dashur dhe kanë kërkuar kushte tjera por ata vetë nuk kanë pranuar se kompania “Bifurkacioni” ka dashur me i vendos orët dhe me i futur në pagesë dhe do të rregullohej çështja e ujit kështu që ata nuk kanë pranuar.

Kryesuesi thekson:- hedh në votim propozimin e asamblistit z.Mefail Suma për një pike të rendit të ditës; rezultati i votimit ishte 1 për, 3 abstenime, 10 kundër. A ka edhe ndonjë diskutim për rendin e punës, nëse nuk ka e hedh në votim rezultati i votimit ishte 13 për, 1 kundër (prezent ishin 14 anëtarë të kuvendit të komunës).

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedhë në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin 14 anëtarë të kuvendit të komunës).

MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Miratimi i grupit punues për hartimin e planit të punës së kuvendit të Komunës për vitin 2020.

Kryesuesi thekson:- kjo pikë e rendit të punës është diskutuar shumë në KPF dhe sa për njoftim në KPF jemi dakorduar që të vazhdohet me komision sikur vitet tjera. Vitet e tjera e kemi pasur KPF – në dhe një propozim ka qenë Drejtorin e Financave dhe z.Mefail Suma. Në KPF u dakordua që znj.Samire Curri për anëtarë të komisionit ta zëvendëson z.Nuriman Kuka. Lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin 12 anëtarë të kuvendit të komunës)

U MIRATUA THEMELIMI I GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2020

3. Informatë mbi raportin e auditorit të përgjithshëm për komunën për vitin 2018.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Mehmet Ballazhi thekson:- megjithëse unë e kam diskutuar edhe në KPF ajo që më së shumti duhet të na shqetësojë të gjithë neve jo vetëm si opozitë ose si individë, si anëtarë të kuvendit, dhe si institucion i komunës duhet të na shqetësojë mungesa e auditorit të brendshëm. Arsyet i kemi thënë disa herë që i dimë gjithë. Arsyetimi që nuk ka auditorë të brendshëm gjithherë më është dukur banale dhe është banale se arsyetim pse nuk ka buxhet ose nuk ka një numër të punësuarve që nuk e ka lejuar qeveria kjo për mua është banale për shkak se nëse një periudhë kohore ta marrim 10 vjeçare është mungesë e auditorit brenda kësaj periudhe ka pasur mundësi me anashkaluar një të punësuar kudo tjetër dhe me hyjë në rendin e punëtorëve si auditorë i brendshëm, apo me gjetë ndonjë mundësi ligjore me kryer auditimin e brendshëm me mënyra të tjera nëse hulumtoni dhe jo si vend i përhershëm por me kontrata mbi vepër ose diçka e tillë por mos të kemi asnjë auditorë është më keq edhe për juve si ekzekutiv por edhe për ne si legjislativ se është ndryshe kur auditori paraprinë defekteve mos me potencuar keqpërdorimeve e zakonisht po paragjykojmë këtu po bëhen keqpërdorime sepse auditori e ka qëllimin e përmirësimeve të gabimeve ose parandalimin e gabimeve, një lloj katalizatori i veprimeve brenda institucionit dhe besoj ashtu siç është emergjente zgjidhja e çështjes së ujit ashtu edhe zgjidhja e çështjes së auditorit të brendshëm të komunës.

Mefail Suma thekson:- nuk jam i përgatitur shumë për raportin e auditorit dhe me siguri ai i ka kryer punët ashtu siç janë por çdo kund një fjali apo një periudhë me e marr me shqyrtuar mirë do të na merrte shumë kohë por sa për fillim po e përmend diku te theksimi i çështjes në realitet opinionin e pamodifikuar me theksim të çështjes apo opinionin e auditorit të përgjithshëm të çështjes. Faqe tre ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se gjendja e investimeve kapitale të shpalosura në pasqyrat financiare vjetore në vlerë prej 1,091,818€ nuk përputhet me vlerën financiare të pasurive jofinanciare në regjistrin e aseteve për diferencën prej 663,825€. Po ashtu asetet kapitale janë të mbivlerësuar për vlerën prej 32,305 €, kërkoj sqarim më gjerësisht. Komuna siç shihet ende nuk e ka regjistrin e pasurisë së patundshme të komunës dhe nëse është a ka mundësi me na i dërguar në mënyrë që me pa se çka ka komuna pronë të patundshme, asete, sa janë të vlerësuar në mënyrë që ta dimë së paku.

Nora Xhoni thekson:- kur është bërë decentralizmi në vitin 2008 qarkullimi nën dy milion euro nuk iu është lejuar komunave që me pasur auditim të brendshëm, mirëpo tash e kemi mundësinë me bërë. Dihet se është një veprimtari e pavarur dhe na ndihmon dhe mundemi me bërë kërkesën që me na u lejuar.

Sabedin Hasallari thekson:- a është mungesa e auditorit të brendshëm që e ka bërë Zyra Kombëtare e Auditimit apo është e paraparë me ligj që me kryer edhe Zyra e Auditorit , në qoftë se ekziston auditori i brendshëm a do ta bëjnë këtë auditim tek auditori i brendshëm. A bëhet edhe nëpër komuna të tjera se këtu po shihet një firmë private “Univerzum Audit” Sh.p.k. e cila e ka kryer auditimin në komunën tonë ?

Rufki Suma thekson:- është obligim ligjorë të ketë komuna auditorë të brendshëm dhe po ndërlidhem me atë që e përmendi, mirëpo kur ne kemi dashur para dy viteve me pranuar auditorë , na është rekomanduar që komunat që i kanë nën 2 milion ose 3 milion nuk kanë të drejtë të kenë auditorë që ne realisht nuk e plotësojmë atë kriter,

por pavarësisht edhe nëse e ke auditorin e brendshëm me ligj parashihet që auditori gjeneral pra Zyra Kombëtare e Auditimit i dërgon auditorët nëpër çdo komunë, auditohen edhe ndërmarrjet publike, çdo institucion por kur është auditori brendshëm ai e kontrollon komunën vazhdimisht dhe auditori i jashtëm ka edhe auditorë të shtetit por kur nuk mundet t'i mbulon të gjitha auditori gjeneral shpall tender për kompani dhe i përcakton kompanitë nëpër komuna të ndryshme mirëpo në mungesë të auditorit të brendshëm i lejohet komunës me i bërë kërkesë Ministrisë së Financave që kjo ministri i dërgon auditorët shtetëror që ata me i audituar dhe ne i kemi pasur për çdo vit por nuk na është dhënë vërejtje për shkak se e ka kryer ministria edhe për vjet kanë pasur plan me ardhur por në fund na kanë thënë që nuk kemi pasur mundësi me ardhur me i kryer që do të thotë edhe sikur ta kemi auditorin është obligim ligjor Zyra Kombëtare e Auditimit e kryen auditimin. Te regjistrimi i pasurisë ka pasur më herët vërejtje tash nuk janë ato vërejtjet e mëparshme, ka filluar regjistrimi i pasurisë edhe për pronat e paluajtshme por nuk ka përfunduar derisa nuk përfundon auditori e vlerëson që nuk ka përfunduar. Te auditimet te pasuria nën 1000 € ka filluar dhe ka përfunduar.

Shabi Rexhallari thekson:- ky raport është publikuar në ueb faqe te Zyrës Kombëtare te Auditimit si dhe ueb-faqe zyrtare te komunës. Auditimin e Pasqyrave Financiare Vjetore të Komunës së Hanit të Elezit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018 e ka kryer kompania “Univerzum Audit” Sh.p.k., në emër të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës. Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Hanit të Elezit, Opinioni i auditimit i pamodifikuar me theksim të çështjes. ZKA ka audituar PFV-të e Komunës së Hanit të Elezit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare. Sipas opinionit të ZKA, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregulloren për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore. Zyra Kombëtare e auditimit ka dhene rekomandimet për komunën e Hanit te Elezit. Siç e dini edhe ju për vitin 2017, komuna e Hanit te Elezit ka pasur 8 rekomandime, prej tyre:

- 1 është i zbatuar plotësisht (Verifikimi i 1/3 pronave të regjistruara te TP)
- 3 në proces të zbatimit: 1. Trajtimi i llogarive te arkëtueshme bëhet fjalë për: a) Te hyrat nga tatimi ne prone, b) Te hyrat nga ushtrimi i veprimtarisë biznesore dhe c) te hyrat nga qeraja 2 Nivel i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm 3 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut
- 4 te pazbatuara : 1. Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim (Shkaqet te theksimi i çështjes dhe mos regjistrimi i plote i pasurisë komunale 2. Mos arkëtimi i taksës në biznes, 3. Menaxhim i pasurive jo financiare dmth pasurit nen 1,000 € inventarizimi dhe zhvlerësimi i tyre. 4. Mungesa e themelimin të Njësisë së Auditimit të Brendshëm apo rekrutimi i një auditori te brendshëm. Tani për vitin 2018 i kemi vetëm 7 rekomandime ku i keni te paraqitura në këtë informatë në faqe 22 dhe 23. Tani komuna ka hartuar dhe përgatitur edhe planin për zbatimin e këtyre rekomandimeve te dhëna nga ZKA, ku aty shihen se kush janë bartësit për zbatimin e këtyre rekomandimeve.

Mehmet Ballazhi thekson :- për atë se është obligim auditimi ju juristët e dini më mirë dhe është obligim është ligjor. Auditori i brendshëm do t'i kishte ndihmuar të gjithëve edhe ne edhe juve si ekzekutiv. Për atë se çka auditon janë kriteret, janë rregullat të përcaktuara me ligj se çka auditon. Sikur ne do ta kishim auditorin e brendshëm do të ishte diçka tjetër ne krahasim me rekomandimet që kanë ardhur nga 8 rekomandime që kanë ardhur për realizimin ose plotësimin e këtyre të gjeturave të auditorit nuk besoj qe do të kishte ndodhur kjo që kanë mbetur 7 disa në proces e disa të pazbatuara. Do të ishte mirë ta merrni seriozisht këtë çështje sepse auditorët tani janë më duket nga ky vit ka kompani të cilët janë privat dhe të licencuar për auditorë të jashtëm që është obligim i tyre pavarësisht a kemi ne apo nuk kemi auditorë të brendshëm. Auditori i auditonë raportet financiare, menaxhimin e financave, projektet dhe gjithë shqetësimet që i qesim ne dhe do ta kemi më lehtë bashkëpunimin me ekzekutivin e me qytetarët dhe do të jemi më transparent në opinion, duhet me këmbëngulë që auditori duhet të jetë dhe duhet me gjetur mënyra.

Mefail Suma thekson:- u përmend që në vitin 2017 auditori i ka dhënë 8 rekomandime ndërsa për vitin 2018 i ka dhënë 7 rekomandime. A ka ndodhur ndonjë vit që auditori i jashtëm nuk ka dhënë asnjë rekomandim? Andaj si mendoni nëse për çdo vit nga një rekomandim më pak a duhet 7 vjet të presim që komuna mos të ketë rekomandime. A bëhet ndonjëherë që të gjitha rekomandimet që janë dhënë me u hequr nga kjo letër?

Kryesuesi thekson:- secili e ka mendimin e tij por është problemi se te rekomandimet ju e dini se këtë mandat nuk kemi pasur rekomandime por në krahasim me komunat tjera më së paku rekomandime kemi ne, kuptohet se edhe këto duhet t'i plotësojmë e nuk them që duhet të vetëkënaqemi por shikoni komunat e tjera minimumi 15 rekomandime i kanë ne krahasim me komunat e tjera që kanë edhe auditorë të brendshëm kemi më së paku rekomandime. Rekomandime do të kemi gjithmonë sepse ndryshon sistemi i pagave, i transfereve prandaj gjithmonë do të kemi rekomandime dhe janë të mirëseardhura sepse qëllimin e kanë që të përmirësohemi.

Mefail Suma thekson:- edhe unë mendoj që nuk ka vetëkënaqësi por te krahasimi me komunat e tjera ato kanë edhe të hyra më shume, buxhetin ta zëmë e kanë të dyfishuar dhe pesëfishuar në krahasim me Hanin e Elezit dhe sa para të kesh aq gabime bën se kështu nuk ke si me gabuar sepse aq buxhet ke dhe del në dukje menjëherë. Nëse do t'i kishte 20 milion të hyra me siguri do t'i kishim 20 rekomandime por edhe kështu mua më duket 7 rekomandime janë shumë me një buxhet 2 milion euro të hyra.

Kryesuesi thekson:- edhe një sqarim në trajnime Hani i Elezit përmendej me më së paku rekomandime por nuk jemi keq dhe duhet edhe këto t'i plotësojmë. A ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

4. Plani i veprimit të Komunës së Hanit të Elezit për adresimin e rekomandimeve të raportit të auditimit 2018.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Shabi Rexhallari thekson:- përveç materialeve të cilat ua kam përcjell diçka të veçant nuk kam. Nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

Mehmet Ballazhi thekson:- a ka afat të realizmit të këtyre pikave?

Shabi Rexhallari thekson:-po ka dhe i keni datat e përcaktuara për secilin rekomandim.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

5. Miratimi i propozimit të planit të veprimit për transparencë 2019-2023.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Edon Curri thekson:- udhëzimi administrativ dhe rregullorja për transparencë na obligon që komuna me hartuar edhe këtë plan. Plani është për katër vite dhe është hartuar në bashkëpunim me Asociacionin e Komunave të Kosovës. Nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

Mefail Suma thekson:- ku është dallimi në mes planit të veprimit dhe rregullores që e kemi miratuar në mbledhjen e kaluar. Pse nuk futet në rregullore por paraqitet si aneks? A duhet të zbatohet rregullorja apo duhet të zbatohet plani i veprimit? Unë vërejta se janë disa kompetenca pak të shtuara dhe nuk rrjedh komplet prej rregullores.

Edon Curri thekson:- komuna do të vepron në bazë të këtij plani për katër vite. Planin rrjedh prej udhëzimit administrativ dhe prej rregullores për transparencë. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal i ka rekomanduar komunës me hartuar këtë plan.

Mehmet Ballazhi thekson:- unë isha shumë skeptik për miratimin e këtij plani por megjithatë do ta miratojë për arsye se më mirë me pasur një plan se sa mos me pasur pavarësisht a është i mirë apo i keq. Planin bëhet për realizim dhe do ta shohim në të ardhmen se sa po realizohet plani në fjalë.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin 12 anëtarë të kuvendit të komunës).

U MIRATUA PLANI I VEPRIMIT PWR TRANSPARENCW 2019-2023

6. Njoftim për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për gjashtë mujorin e vitit 2019.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Rufki Suma thekson:- materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

Mefail Suma thekson:- në fshatin tonë ende kemi rrezik prej ujqërve për shkak se dje është ndjekur nga ujku edhe një fëmijë por fatmirësisht ka shpëtuar. Po ashtu një ditë e ka ndjekur edhe bariun e deleve por tash i ka hequr prej fshatit Dimcë delet sepse kryetari patë potencuar se ka vend për 5000 dele por unë them që nuk ka. Vazhdon rreziku dhe nuk largohen ujqit shihen për çdo ditë.

Mehmet Ballazhi thekson:- a ka procesverbale kur mbahen mbledhjet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi dhe do të ishte mirë që me i shikuar procesverbalet se çka diskutohet në mënyrë që të jemi më të informuar. Personat të cilët janë pjesë e KKS-së a marrin pjesë çdo herë në takime të KKS-së. Në Komitet për Politik e Financa e kemi diskutuar çështjen e ujkut por kemi potencuar se e njëjta çështje mund të ndodh edhe me qentë endacak dhe si komunë duhet të mendoni më seriozisht dhe më me urgjencë për shkak se mund të ndodhë edhe prej qenve endacak që me u sulmuar ndonjë fëmijë apo qytetarët. Është shënuar se janë larguar fëmijët prej pikës kufitare por problemi është se si do të trajtohen ato fëmijë të cilët janë larguar prej zonës kufitare.

Florim Shkreta thekson:- procesverbalet duhet të dërgohen si material. Ne kemi zgjedhur kryeadministratorin e fshatrave për me marr pjesë në mbledhje të KKS-së por në material nuk figuron. Në material është potencuar identifikimi i vendosjes së kamerave kërkoj sqarim se ku do të vendosen dhe a kanë efekt ata të cilët janë të vendosura.

Rufki Suma thekson:- procesverbalet janë të publikuara në uebfaqe të komunës. Ne kemi biseduar se nëse rrezikohet jeta e qytetarit qoftë prej qenve endacak, qoftë prej ujkut apo ariut duhet të vritet sepse më e rëndësishme është jeta e njeriut por shoqatat kërkojnë që tu ipet leje dhe me shfrytëzuar pastaj për gjueti. Policia ka biseduar dhe ka pasur takim në komunë për çështjen e fëmijëve të cilët rrinë te kufiri për shkak se po krijojnë një imazh të keq. Ju është dhënë vërejtje disa herë prej policisë dhe janë biseduar këto çështje përmes udhëheqësit të Qendrës për Punë Sociale. Ka pasur raste që janë dënuar prindërit e fëmijëve. Pjesëmarrjen në mbledhje të këshillit komunal për siguri në bashkësi është e përcaktuar me udhëzim administrativ. Koordinatori i këshillave të fshatrave merr pjesë si përfaqësues prej bashkësisë islame të Hanit të Elezit. Pjesëmarrja e anëtarëve është rregull me përjashtim ndonjë herë mungon ndonjëri. Kamerat e kanë treguar efektin e vetë për shkak se përmes kamerave janë zbuluar vjedhjet të cilat janë bërë, rastet e hedhjes së mbeturinave. Kamerat do të vendosen edhe në disa vende kyçe të cilat i ka planifikuar policia.

Florim Shkreta thekson:- a mund të më tregoni ndonjë rast që përmes kamerave është verifikuar dhe është zbuluar. Te vendi i quajtur Ura e Seçishtës kamerat janë të vendosura por cili person është dënuar për shkak se vazhdimisht hedhin mbeturina.

Rufki Suma thekson:- unë potencova që janë dënuar te Ura e Seçishtës personat. Janë dënuar kur janë dëmtuar me vetura rrethojat e drunjve dekorativ . Janë identifikuar ndeshjet në komunikacion përmes kamerave.

Mefail Suma thekson:- a vendosen kamerat për me i zbuluar qytetarët të cilët bëjnë gabime apo për me i edukuar qytetarët. Është mirë me vendosur shenja që ka kamera sepse më shumë ruhen qytetarët mos me shkaktuar probleme për shkak se vendosja e kamerave të ketë një qëllim edukativ.

Hanumshahe Dibrani thekson:- para tri ditë janë hedhur mbeturina te Ura e Seçishtës a iu ka dhënë informacione policia.

Rufki Suma thekson:- polica nuk na ka dhënë ndonjë informacion për te Ura e Seçishtës. Vendosja e kamerave ka për qëllimin sigurinë dhe është obligim ligjor me pasur shenja dhe në hyrje të Hanit të Elezit dhe te kufiri është shenja që qyteti është në vëzhgim të kamerave.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

7. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Hanumshahe Dibrani thekson:- çështja e orëmatësve të ujësjellësit është pak problem për shkak se një familje prej pesë anëtarëve paguan 25.00 € që do të thotë është tarifë shumë e lartë.

Refet Kalisi thekson:- sipas informacioneve që kam pa shpenzuar ora nuk regjistron . Shumë qytetarë ankohen për çështje të orës dhe është mirë me bërë kërkesë te zyra e “Bifurkacionit” dhe del komisioni në teren dhe e verifikon.

Mehmet Ballazhi thekson:- është vërtetuar që orëmatësit kanë një problem por shkaktari nuk po dihet, mirëpo gjatë bisedave që kam pasur me qytetarë kanë potencuar që kur nuk ka ujë dhe në momentin që lëshohet uji, ajri ka shtypje aq të madhe që deri sa të vjen uji po e krijojka një lëvizje të madhe të orës që e rrit kubikazhën. Kërkoj që në mbledhjen e ardhshme të kuvendit të komunës me marr pjesë drejtoi i “Bifurkacionit” për shkak se kemi shqetësime të ndryshme.

Florim Shkreta thekson:- në faqe të komunës së Hanit të Elezit lexova për punëtorin më të dalluar të komunës. Si ka shkuar mënyra e përzgjedhjes së punëtorit më të mirë të komunës Hanit të Elezit. Kërkoj akt emërimit e gjithë atyre të cilët janë zgjedhur më të dalluar. Datën e fillimit të punës dhe kur janë shpallur më të dalluar prej momentit që ka filluar përzgjedhja e punëtorëve më të dalluar.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen e kuvendit të komunës. Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 12:27

Procesmbajtësi

Ayni Bushi

